

Njohja e Palestinës si shtet vjen në rendin e ditës në Parlamentin italian, raporton Anadolu Agency (AA).

Anëtarët e partisë më të madhe në pushtet, deputetët të Partisë Demokratike me mbështetjen e deputetëve të partive të tjera të majta kanë paraqitur një propozim në lidhje me njohjen e Palestinës.

Propozimi pritej që të votohej ditën e nesërme, por për shkak të diskutimeve të tjera të Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës së Përfaqësuesve në lidhje me paketat e reformave pritet që ky votim të jetë në axhendën e Parlamentit në ditët në vijim.

Ndërsa partia opozitare, Partia Bashkimi Verior ka njoftuar se nuk do të votojë propozimin për njohjen e Palestinës pa patur një marrëveshje dypalëshe mes Izraelit dhe Palestinës.

- Reagime nga Izraeli -

Ambasada e Izraelit në Romë ka reaguar në lidhje me propozimin për njohjen e Palestinës, ku e ka cilësuar propozimin si të parakohshëm. "Çdo njohje e parakohshme, krahas nxitjes së palestinezëve do të largojë ata nga mundësitë për të bërë paqe me Izraelin"- thuhet në reagimin e Ambasadës së Izraelit në Itali.

Suedia është e para që ka njohur Palestinën si shtet duke qenë një vend anëtar i BE-së. Ndërsa vendet si Polonia, Rumania, Hungaria, Republika Çeke, Bullgaria, Qiproja Greke dhe Malta e kanë njohur Palestinën si shtet përpara se të bëheshin vende anëtarë të BE-së.